



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës

Adresa: Rr. Tahir Sinani 50, Shtime, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Shtimes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KSH kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e

audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës së Shtimes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtimes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtimes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të

përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtimes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtimes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur më poshtë në Grafikon 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të komunës. Zbatimin e rekomandime të dhëna në këtë raport do ta shqyrtojmë gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Çështjet për pasqyrat financiare

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Çështja C1 - Mangësi në raportimin e pasurive jo financiare në PFV

Gjetja Rregullorja MF - NR.02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 24 pika 1 përcakton se: Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare, si dhe neni 6 pika 3 përcakton se pasuria jo kapitale duhet të regjistrohet në "e - pasuria".

Komuna nuk ka arritur që të bëjë barazimin e gjendjes në regjistrat e pasurive me gjendjen e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare, para përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore. Kjo ka ndodhur si shkak i mos përfundimit të punës me kohë nga komisioni i vlerësimit. Po ashtu "Furnizimi me pajisje të TI-së dhe kamera për institucionet e Komunës së Shtimes - Faza dytë" në vlerë prej 23,658€ nuk ishte regjistruar në e-pasuria dhe nuk ishte shpalosur në PFV. Kjo ka ndodhur shkak i mos pranimit të furnizimeve përmes deposë.

Mos barazimi i regjistrave të pasurive ka ndodhur shkak i mos përfundimit të punës me kohë nga komisioni i vlerësimit. Po ashtu mos regjistrimi i pasurive ka ndodhur shkak i mos pranimit të furnizimeve përmes deposë.

Ndikimi Mos barazimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive pamundëson konstatimin e gjendjes reale të pasurive në përdorim. Kurse, mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria ka ndikuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive jo financiare të prezantuar në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se vlera e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e PFV në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. Pra, rezultatet e gjendjes së inventarizimit dhe vlerësimit duhet të reflektojnë ndryshimet e fundvitit në regjistrat kontabël të pasurive. Ndërsa, të gjitha blerjet e reja të pasurisë gjatë vitit, varësisht nga vlera e tyre, duhet të procesohen në sistemet përkatëse të regjistrimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2020 nga Komuna e Shtimes në 2020 ishin 338,196€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, etj. Nga aspekti i menaxhimit të tatimit në pronë, inspektimi i objekteve brenda territorit të komunës nga departamenti i tatimit në pronë nuk ka arritur të përfundoj nivelin e kërkuar prej 20%. Nga komuna janë inspektuar vetëm 3% të objekteve për shkak të rrethanave të krijuara me shfaqjen e pandemisë Covid-19, dhe si pasojë vizitat në terren të zyrtarëve inspektues kanë qenë të vështirësuar.

Çështja B1 - Mos barazimi i të hyrave në mes të departamenteve dhe zyrtarit të të hyrave

Gjetja

Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat vetjake, neni 13, pika 3.3, përcakton se organizata buxhetore është e obliguar që ta bëjë barazimin e të hyrave me evidencat e Thesarit. Për tu kryer kjo, drejtoritë përkatëse në komunë duhet që çdo muaj të bëjnë barazimin e të hyrave sipas departamenteve me zyrtarin e të hyrave. Përveç regjistrimit të të hyrave vetjake si dhe harmonizimit mujor dhe tremujor në Thesar, kërkohet edhe harmonizimi i të hyrave në mes të Departamenteve dhe Zyrtarit të të hyrave në komunë i cili duhet të bëhet çdo muaj.

Edhe gjatë vitit 2020 sikurse edhe vitin e kaluar, ka mbetur gjendja e njëjtë sa i përket barazimeve mujore mes zyrtarit të të hyrave dhe pesë (5) drejtorive komunale. Përkundër kërkesave dhe dërgimit të formës së barazimit nga ana e Zyrtarit të të hyrave, ende nuk ka pasur përgjigje pozitive për realizimin e barazimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos gatishmërisë dhe neglizhencës së zyrtarëve të drejtorive përkatëse të cilët përkundër rekomandimit tonë dhe planit të veprimit të komunës, nuk kanë ndërmarrë masa përmirësuese.

Ndikimi

Mos realizimi i barazimeve mujore në mes drejtorive komunale me zyrtarin e të hyrave rritë rrezikun për informacion të mangët dhe, rrjedhimisht edhe për raportim të pasaktë të të hyrave vetjake.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës, duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Llogaritje e gabuar e tarifave për leje ndërtimore**Gjetja**

Udhëzimi Administrativ MMPH nr.02/18 neni 5.1, si dhe rregullorja komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2020 neni 4.3, definojnë mënyrën e llogaritjes së taksës administrative për leje ndërtimore të Kategorisë II. Kjo përcaktohet duke shumëzuar koston (tarifën) për metër katrorë me numrin e metrave katror bruto të ndërtimit.

Llogaritja e taksës administrative për lëshimin e një leje ndërtimore të Kategorisë II ishte bërë gabim, me ç' rast si bazë për llogaritje nuk ishte marrë sipërfaqja totale bruto e ndërtimit të objektit prej 652.66m², por është marrë sipërfaqja 284.12m². Rrjedhimisht, tarifa ishte llogaritur për 368.54m² më pak, të cilat kur shumëzohen me çmimin prej 2€ për m², del të jenë inkasuar më pak të hyra prej 737€. Bazë për këtë janë metrat katror të paraqitura në projektin kryesor detal, si dhe përshkrimi i sipërfaqes totale të objektit në vendimin e lejes ndërtimore.

Sipas shpjegimeve të menaxhmentit, gabimi ka ndodhur për shkak të ngarkesave të stafit, ngase zyrtari që ka bërë llogaritjen e tarifës ka qenë i ngarkuar edhe me legalizim të ndërtimeve pa leje dhe si zyrtar për menaxhimin e projekteve në terren.

Ndikimi

Llogaritja e gabuar e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore ka ndikuar që të arkëtohen më pak të hyra gjatë vitit 2020, rrjedhimisht edhe të dëmtohet fondi i të hyrave vetjake të komunës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të fuqizoj kontrollet administrative në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në mënyrë që llogaritja e tarifave për shërbimet ndaj qytetarëve të jetë në harmoni me rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba të komunës, si dhe me udhëzimin përkatës. Ndërsa personit që ka marrë lejen ndërtimore, t'i kërkohet ta paguaj diferencën që ka rezultuar si gabim në llogaritje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për 2020 është 4,275,804€, ndërsa janë shpenzuar 4,274,089€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 665 ndërsa në fund të vitit numri i tyre aktual ishte 654. Gjatë vitit 2020 ishin punësuar 50 punëtorë të rinj, prej tyre 42 janë të punësuar në arsim dhe tetë (8) në shëndetësi. Për qëllime rishikimi, kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 14,624€, si dhe 30 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Pagesa e zyrtarëve të AME-së në mungesë të informatave për dosjen e tyre

Gjetja

Bazë për kompensimin e pagave dhe shtesave eventuale duhet të jetë kontrata e punës dhe dëshmitë se punonjësit kanë punuar gjatë muajit përkatës.

Komuna kishte vazhduar të kompensoj tetë (8) zyrtarë/zjarrfikës, në mungesë të informatave (kontratave dhe dëshmime të punës). Kjo ka ndodhur si pasojë e asaj se këta zyrtarë, sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si punëtorë të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, të gjitha kompetencat rreth menaxhimit, përfshirë menaxhimin e dosjeve të punëtorëve janë bartur nga Komuna në AME, respektivisht MPB. Megjithatë, buxheti i pagave për këtë staf, ka mbetur ende tek komuna. Prandaj, komuna vazhdon të kryej kompensimin e pagave dhe shtesave nga buxheti i saj. Pagat dhe shtesat për këta punëtorë gjatë vitit 2020 ishin 71,155€.

Kjo çështje do të vazhdoj të përsëritet vit pas viti, derisa Ministria e Financave nuk ndërmerr hapa për bartjen e buxhetit në MPB.

Ndikimi

Pagesa e zyrtarëve në mungesë të kontratave, mund të rezultojë me pamundësinë për të justifikuar pagesën e pagave dhe shtesat eventuale.

Rekomandimi B2

Kryetari, deri në bartjen përfundimtare të buxhetit tek MPB, duhet të kërkoj nga menaxhmenti i AME-së, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku kontratat për punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët që kanë përmbushë detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 1,747,374€, prej të cilave ishin shpenzuar 1,161,520€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, furnizim me pajisje, furnizime mjekësore, shërbime kontraktuese tjera, shpenzime komunale, etj. Ne kemi testuar 12 mostra për teste substanciale në vlerë 166,350€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mos pranimi i mallrave/shërbimeve nga Zyrtari i pranimit/logjistikës

Gjetja

Rregullorja MF - Nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 8, pika 2 dhe 3 përcakton që për rastet kur pranimi i pasurisë jo financiare bëhet drejtpërsëdrejti nga furnitori te përdoruesi, pa kaluar nëpërmes deposë qendrore, Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të aprovoj procedura të qarta të pranimit duke përcaktuar përgjegjësinë përkatëse (verifikimi i sasisë, vlerës dhe cilësisë që i referohen kushteve me kontratë) të menaxhimit dhe përdorimit.

Për kontratën "Furnizim me Pajisje të TI-së dhe kamera për institucionet e Komunës së Shtimes-Faza dytë" në vlerë prej 23,658€, pranimi i pajisjeve ishte bërë nga komisioni mbikëqyrës për pranimin teknik të furnizimeve dhe menaxheri i kontratës. Gjatë ekzaminimit fizik kemi vërtetuar që furnizimi me projektorë në disa shkolla nuk kishte të njëjtat specifika me ato në kontratë, por as nuk ishin të njëjtit brend. Shumica prej tyre ende nuk ishin funksionalizuar. Ndërsa, disa nga kamerat për institucionet e komunës (që i përkasin të njëjtës kontratë), e që nuk ishin funksionalizuar, gjendeshin në zyrën e menaxherit të kontratës, pa një specifikacion mbi pajisjet e mbetura në stok. Për kontratën "Furnizim për zyrë" në vlerë prej 42,421€ pranimi dhe shpërndarja e furnizimeve të kërkuara ishte bërë nga menaxheri i kontratës. Pranimi i furnizimeve nuk ishte bërë nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës dhe se të njëjtat nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Megjithatë, komuna ka bërë shpalosjen e pasurive të paregjistruara në PFV të vitit 2020, nën raportin tek Neni 19.3.2.

Pranimi i furnizimeve pa kaluar nëpër depo dhe mos verifikimi i specifikave, ka ndodhur shkaku i pagesave në fund vit dhe kontrolleve të pamjaftueshme, si dhe ka rezultuar me mos regjistrim të pasurive në sistemin e-pasuria.

Ndikimi

Menaxhimi i pasurive siç u përshkrua më lart, ka ndikuar në pranimin e furnizimeve jashtë specifikave të kontratës, si dhe në nënvlerësim të vlerës së pasurive dhe shpalosjen e tyre jo të plotë në PFV.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës të komisioneve për pranimin e mallrave/furnizimeve nuk duhet të pranojnë asnjë artikull që nuk është në përputhje me specifikat e kontratës. Ndërsa, pranimi i furnizimeve të bëhet nga Zyrtari i pranimit/logistikës, si dhe pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 351,145€, prej të cilave në 2020 ishin shpenzuar 267,401€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencione për entitete publike dhe jo publike. Në këtë kategori kemi testuar shtatë (7) mostra për teste substanciale në vlerë 18,360€ si dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Dobësi në zbatimin e rregullores për subvencione

Gjetja Rregullorja komunale për ndarjen e subvencioneve të komunës së Shtimes, neni 13, përcakton se për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e komunës dhe përfituesit. Po ashtu, sipas të së njëjtës rregullore, neni 7 pikës 7.3, definohet edhe përbërja e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të subvencioneve, me ç'rast kërkohet që anëtarët duhet të jenë shërbyes civil të komunës.

Me rastin e dhënies se subvencioneve për përfituesit sipas listës përfundimtare nga thirrja publike për aplikim e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale, kemi vërejtur se nuk janë hartuar marrëveshjet për subvencionim në mes përfituesit të subvencionit dhe komunës.

Komisioni i krijuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në Komunën e Shtimes, i cili komision ka bërë edhe vlerësimin e të gjitha kërkesave të subvencioneve në komunë është i formuar në kundërshtim me rregulloret përkatëse në fuqi. Njëra anëtare e këtij komisioni, përveç që është e punësuar përmes Ligjit të punës në Drejtorinë e Kulturës, është edhe këshilltare në Kuvendin komunal të Shtimes.

Sipas komunës, shkak për mungesën e marrëveshjeve mes përfituesve të subvencioneve dhe Drejtorisë së Shëndetësisë është ngarkesa në punë nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19. Kurse për përbërjen jo të duhur të komisionit të vlerësimit të subvencioneve, arsye ishte mungesa e njohurive të ekzistencës së një kërkese të tillë në rregulloren e subvencioneve.

Ndikimi Mungesa e marrëveshjeve mund të ndikojë në shpenzimin e fondeve jashtë objektivave të subvencioneve, rrjedhimisht edhe në dështim të projekteve. Komisioni jo i duhur i vlerësimit të kërkesave të subvencioneve mund të ketë pasojë mungesën e duhur të kompetencës dhe trajtimin jo të duhur të përfituesve.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e ndarjes së fondeve për subvencione, do të zbatohen të gjitha kërkesat që dalin nga rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve si dhe ligjet tjera në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,263,899€, dhe prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 2,117,646€. Ato kanë të bëjnë me objekte arsimore, ndërtimin e rrugëve lokale, trotuare, kanalizime, mirëmbajtje investive etj. Nga kjo kategori kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 897,473€, si dhe gjashtë (6) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Menaxhim i dobët i fondeve për projekte kapitale

Gjetja Bazuar në Rregullën Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, Neni 5 Ndarjet buxhetore - Në procesin e ndarjeve buxhetore, OB-të janë të obliguara që të ofrojnë të gjitha të dhënat e nevojshme konform kërkesave të Nenit 21, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Për projektin “Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc” është nënshkruar kontrata (154,251€) për punë në vitin 2019 dhe një aneks kontratë (15,374€) në vitin 2020, që në total kapin vlerën 169,625€. Realizimi i buxhetit nga kodi për këtë projekt për të dy vitet ishte 180,000€. Nga kjo, vlera e mbetur prej 10,375€ është shpenzuar për projektin tjetër, “Lasgush Poradeci-Muzeqinë” për pagesën e situacionit të dytë të punimeve të kësaj shkolle.

Në dhjetor të vitit 2020 është nënshkruar kontrata për “Vazhdimin e ndërtimit të shkollës fillore amë Lasgush Poradeci - Muzeqinë” (60,694€). Për këtë projekt është kryer edhe një pagesë për situacionin e parë në dhjetor të 2020 nga kodi i projektit joadekuat “projektet për infrastrukturë arsimore me participim” në vlerë 20,000€. Si pasojë e projektit të pa planifikuar (pa fonde të mjaftueshme), janë shfrytëzuar mjetet nga kodi i projekteve tjera.

Për projektin “Rregullimi i Ndriçimit Publik” komuna ka kontratën kornizë të nënshkruar në vitin 2018 e cila përfundon në maj të 2021. Megjithatë, për arsye të panjohura, komuna ka nënshkruar kontratë tjetër për të njëjtat shërbime në dhjetor të vitit 2020 në vlerë prej 22,526€, por me operator tjetër. Pagesa për kontratën e re për tërë vlerën është kryer në dhjetor të vitit 2020.

Kontratat e nënshkruara në fund vit nuk ishin përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit 2020. Si pasojë e buxhetit të pa planifikuar për projekte, janë shfrytëzuar mjete nga kode jo adekuate të projekteve.

Për çështjet e sipër përmendura, nuk janë dhënë sqarime konkrete nga ana e komunës. Megjithatë, duket se tendenca ishte tek realizimi sa më i madh i buxhetit në fund vit.

Ndikimi Kontraktimi dhe realizimi i projekteve të paplanifikuara, ka ndikim në implikime buxhetore apo jep një pasqyrë jo të qartë për realizimin e ndarjeve buxhetore sipas projekteve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj se ndarja e fondeve buxhetore do të realizohet, vetëm në përputhje me kontratat e lidhura për ato projekte kapitale, të planifikuara në tabelën buxhetore si dhe të përfshira në planin e prokurimit. Derisa, për projektet e paplanifikuara, para nënshkrimit të kontratës të siguroj fondet buxhetore përmes procedurave buxhetore në Ministrinë e Financave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.7 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 51,389,231, pasurive jokapitale 408,634, si dhe e stoqeve 106,330. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,407,035€, si dhe 70 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Mos regjistrim i pasurive kapitale në SIMFK dhe E-pasuria

Gjetja Rregullorja MF – NR. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3, përcakton se: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Gjatë testimit kemi identifikuar se komuna nuk ka arritur që të bëjë regjistrimin në SIMFK për tri pagesa që kanë të bëjnë me shpronësimin e tokave në vlerë prej 80,183€. Po ashtu furnizimi për zyre në vlerë prej 42,421€ nuk figuron në sistemin e-pasuria.

Megjithatë janë bërë shpalosjet e duhura në PFV nën raportin për pasuri neni 19.

Shkaku i mos regjistrimit është se pagesat janë kryer në fund vit, si dhe pjesët (ngastrat) e shpronësuar nuk kanë qenë të ndara nga pjesa e ngastrave të pa shpronësuar (që ishin si një tërësi) në gjeodezi dhe kadastër para përfundimit të vitit.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive ka ndikuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive kapitale.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të siguroj se janë regjistruar vlerat e pasurive jo financiare në regjistrat kontabël sipas rregullores përkatëse për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të jetë pjesë e raportit të PFV në pajtim me rregullat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.8 Të arkëtueshmet

Komuna e Shtimes në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 600,126€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë për objekte dhe parcela, dhe qiraja - shfrytëzimi i pronës publike dhe shfrytëzimi i hapësirave publike.

Çështja B3 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronë, neni 12 paragrafi 2, përcakton se çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.

Komuna e Shtimes për vitin 2020 kishte raportuar llogari të arkëtueshme nga tatimi në prona-objekte prej 498,872€ dhe tatimin në toka prej 100,213€, ku një pjesë e borxheve të grumbulluara të tatimit në pronë prej 42,470€ i përkasin ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Këto llogari të arkëtueshme janë bërë barrë aktuale vjetore e faturës së tatimit në pronë të cilat po rriten vit pas viti, dhe gjasat për inkasim të detyrueshëm mund të jenë të vogla. Sipas kontratës me AKP-në blerësi i ri i pronës shoqërore ka obligim të paguaj tatimin në pronë vetëm për 12 muaj kalendarik, kurse pjesa tjetër e borxhit paguhet gjatë procesit të likuidimit.

Gjatë vitit 2021 Komuna e Shtimes ka patur komunikim me AKP-në dhe priten takime mes palëve për zgjedhjen e problemeve të ngritura, mirëpo deri në kohën e auditimit zgjidhja nuk është arritur.

Shkak pse nuk kanë filluar të zgjidhen me herët këto çështje, është situata e krijuar me pandeminë Covid -19.

Ndikimi

Trendi i rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të borxheve të komunës.

Rekomandimi B3

Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për NSh-të të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e borxheve tjera nga të gjithë shfrytëzuesit e pronave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,127,712	9,638,223	7,820,655	8,476,970	7,360,446
Grante Qeveritare – Buxheti	7,308,061	7,539,941	7,093,061	6,424,316	6,817,758
Financimi përmes huamarrjes	0	45,045	45,045	9,026	3,951
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	1,190,000	1,190,000	255,124	1,471,012	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	232,021	120,349	135,564	145,258
Të hyrat vetanake	629,651	629,651	306,158	315,984	264,692
Donacionet vendore	0	1,440	918	17,284	0
Donacionet e jashtme	0	125	0	103,784	128,787


Buxheti përfundimtar është më i lartë për 510,510€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura 232,021€, donacionet e jashtme 1,565€, financimi nga huamarrja 45,045€ dhe rritja e grantit qeveritar prej 231,879€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 81% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 7,820,655€, me një ulje prej 5% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar në tabelën vijuese.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,127,712	9,638,222	7,820,656	8,476,969	7,360,446
Pagat dhe mëditjet	4,219,348	4,275,804	4,274,089	4,137,294	4,054,787
Mallrat dhe shërbimet	890,000	1,492,368	963,803	732,771	645,594
Komunalitë	220,000	255,006	197,717	191,821	169,491
Subvencionet dhe transferet	150,000	351,145	267,401	126,246	190,178
Investimet Kapitale	3,089,941	3,263,899	2,117,646	3,288,837	2,300,396
Rezervat	558,423	0	0	0	0

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, vetëm 65% e buxhetit ishte shpenzuar. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të pakënaqshëm për Klauzolën e Investimeve për projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza-Shtime". Për këtë projekt figurojnë në ligjin e buxhetit fonde të ndara në vlerë prej 1,190,000€ për vitin 2020, derisa realizimi i shpenzimit për vitin 2020 ishte vetëm 21% ose 255,124€. Arsye e realizimit kaq të ulët ishte për shkak të gjendjes së krijuar nga Covid-19 dhe komunikimit në mes Ministrisë së Financave dhe Operatorit Ekonomik.

Mjetet e ndara në kuadër të kategorisë së rezervave, ishin për mbulimin e obligimeve eventuale nga Ligji i Pagave në Sektorin Publik. Me që ky ligj nuk ka hyrë në fuqi, shfrytëzimi i këtyre fondeve me vendim të kuvendit komunal dhe kërkesave të komunës ishte transferuar nëpër kategoritë tjera në vlerë prej 457,889€, për arsye të mbulimit të obligimeve emergjente në funksion të menaxhimit shëndetësor, si dhe kryerjen e obligimeve sipas prioriteteve për komunën e Shtimes. Kjo ka ndikuar që shpenzimet të përqendrohen më shumë në muajt e fundit dhe ka rezultuar me 19 kontrata jashtë planifikimit të prokurimit, vetëm me njoftim në KRPP.

Përkundër një rritje të buxhetit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime gjatë vitit, vetëm 65% e buxhetit ishte shpenzuar, prej tyre 22,748€ ishin keq klasifikim pagesa me vendim gjykatë për pagat e mësimdhënësve.

Raportimi për shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID -19 ishte shpalosur në PFV sipas kërkesave të thesarit, gjithsej shpenzime janë realizuar 429,542€.

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2020 nga Komuna e Shtimes në 2020 ishin 338,196€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, etj. Po ashtu komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë prej 90,057€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	629,651	629,651	338,196	429,285	340,417
Të hyrat tatimore	279,573	279,573	147,609	173,659	141,231
Të hyrat jo tatimore	350,078	350,078	190,587	255,627	199,185

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Shtimes ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2020, katër (4) rekomandime janë zbatuar; tre (3) ishin në proces dhe tre (3) nuk janë adresuar ende (shih më poshtë Grafikon 4). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve numër 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.	Pavarësisht përpjekjeve dhe dërgimit të mostrave se si të barazohen nga zyrtarja e të hyrave, Çështja mbetet e njëjtë (shih çështjen B1).	Nuk është adresuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj ngë personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu	Bazuar në ligjin Nr. 04/L-149 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, zjarrfikësit e Kosovës nga viti 2011 janë staf i MPB dhe menaxhohen nga Agjencia e	Nuk është adresuar

		siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.	Menaxhimit Emergjent AME. Sfidë ka mbetur bartja e buxhetit në MF nga Komuna në AME. Çështja mbetet e njëjtë (shih çështjen B2).	
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe koha e angazhimit në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.		I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se për çdo dështim të operatorit ekonomik për ti korrigjuar defektet në kohë, dështimet e tilla do të rezultojnë me konfiskim të sigurisë së ekzekutimit dhe të kërkojë zhdëmtim shtesë të shkaktuar nga mospërbushja e kontratës. Po duhet të shikohet mundësia që të plotësohet numri i stafit me kuadro adekuate për menaxher të projektit.	Shih shpenzimet e fondeve sipas kategorive (Klauzola e Investimeve).	Pjesërisht i zbatuar
5.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që janë evidentuar dhe përllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendonjë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë për vonesa dhe shpenzime të përmbarimit.	Pas përpjekjeve nga Komuna, për vitin 2020 MF ka lejuar pagesën e tri pagave pas pensionimit për sektorin e arsimit, derisa për pagat jubilarë nga viti 2021 pritet të bëhet planifikimi. (Shih shpenzimet e fondeve sipas kategorisë Mallra dhe Shërbime).	Pjesërisht i zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit të përfshijë të gjitha pasuritë në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të		I zbatuar

		azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.		
7.	Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i siguruar informatat e nevojshme financiare në lidhje me projektin në mënyrë që objekti në fjalë të evidentohet në regjistrat e pasurive të komunës dhe të shpaloset në PFV.	Kryetari ka marr masa, Objekti i shtëpisë së kulturës është regjistruar në SIMFK sipas Vlerësimit nga komisioni. Megjithatë për vitin 2020 kemi identifikuar pasuri tjera të paregjistruara (Shih çështjen C1, C2).	Pjesërisht i zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-n lidhur me obligimet për NSH -të të cilat janë në menaxhimin e tyre, dhe të ish NSH-ve të privatizuara. Poashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.	Menaxheri i Tatimit në Prone është në proces të komunikimit me zyrtarët e AKP-së. Çështja është e njëjtë (Shih B3).	Nuk është adresuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se Departamenti i tatimit në pronë ti shqyrtojë në kohë të arsyeshme ankesat e pronarëve në lidhje me vlerësimin e pronave. Në rastet kur është e nevojshme të bëhen korigjime të vlerësimeve, duhet të intensifikohet bashkëpunimi me MF për të zgjidhur këtë çështje.	Gjatë vitit 2020 ka pasur vetëm dy ankesa dhe të cilat janë shqyrtuar me kohë.	I zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurohet se emërimi/përbërja e anëtarëve të KA të jetë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-021 mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe udhëzimi administrativ i MF Nr.01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e KA në Sektorin Publik.		I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se vlera e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e PFV në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare. Pra, rezultatet e gjendjes së inventarizimit dhe vlerësimit duhet të reflektojnë ndryshimet e fundvitit në regjistrat kontabël të pasurive. Ndërsa, të gjitha blerjet e reja të pasurisë gjatë vitit, varësisht nga vlera e tyre, duhet të procesohen në sistemet përkatëse të regjistrimit të pasurisë.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të fuqizoj kontrollet administrative në Drejtorinë për Planifikim

		Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në mënyrë që llogaritja e tarifave për shërbimet ndaj qytetarëve të jetë në harmoni me rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba të Komunës, si dhe me udhëzimin përkatës. Ndërsa personit që ka marrë lejen ndërtimore, t'i kërkohet ta paguaj diferencën që ka rezultuar si gabim në llogaritje.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurohet se drejtoritë që realizojnë të hyra bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në dokumente burimore dhe raporte e bankës duke eliminuar me kohë edhe dobësitë apo gabimet e mundshme.
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, deri në bartjen përfundimtare të buxhetit tek MPB, duhet të kërkoj nga menaxhmenti i AME-së, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku kontratat për punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët që kanë përmbushë detyrimet nga marrëdhënia e punës.
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës të komisioneve për pranimin e mallrave/furnizimeve nuk duhet të pranojnë asnjë artikull që nuk është në përputhje me specifikat e kontratës. Ndërsa, pranimi i furnizimeve të bëhet nga Zyrtari i pranimit/logjistikës, si dhe pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e ndarjes së fondeve për subvencione, do të zbatohen të gjitha kërkesat që dalin nga rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve si dhe ligjet tjera në fuqi.
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se ndarja e fondeve buxhetore do të realizohet, vetëm në përputhje me kontratat e lidhura për ato projekte kapitale, të planifikuara në tabelën buxhetore si dhe të përfshira në planin e prokurimit. Derisa, për projektet e paplanifikuara, para nënshkrimit të kontratës të siguroj fondet buxhetore përmes procedurave buxhetore në Ministrinë e Financave.
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se janë regjistruar vlerat e pasurive jo financiare në regjistrat kontabël sipas rregullores përkatëse për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të jetë pjesë e raportit të PFV në pajtim me rregullat financiare.
9.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për NSh-të të cilat janë nën menaxhimin e tyre, dhe të ish NSh-ve të privatizuara. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e borxheve tjera nga të gjithë shfrytëzuesit e pronave.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Sabile Muli, Udhëheqëse e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Fisnik Rudaj, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA SHTIME OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME			
Zyra e Kryetarit			
LETËR E KONFIRMIMIT			
Për pajtueshmërinë me gjetjet Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve			
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit Të nderuar,			
Përmes kësajshkrese, konfirmoj se:			
• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtimes, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.			
Z. Naim Ismajli Kryetar i Komunës së Shtimes Data: 28.qershor.2021, Shtime.			

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.